



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	10.06.2024
REFERENCË:	Nr. 01-020/04-0036983/2/24
PËR/ZA/TO:	Znj. Blerina Kastrati - Udhëheqëse e Njesisë së Komunikimit me Publikun /Zyra e Informimit
CC:	Z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Gëzim Stavileci-drejtor i DAP
NGA/OD/FROM:	Besa Veseli – kryesuese e Grupit Punues për hartimin e Planit Komunal për Barazi Gjinore për vitin 2024 - 2026
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Konsultim Publik

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës; nenin 3 paragrafi 5, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, të UA Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, Komuna shpallë:

KONSULTIM PUBLIK

Për Planin komunal për Barazi Gjinore për vitin 2024-2026

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në debatin publik, i cili do të mbahet ditën e **martë**, datë **18.06.2024**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga **14:00**.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e Planit komunal për Barazi Gjinore, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e domosdoshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i japin përmes e-mail adresës elektronike të Komunës së Mitrovicës komuna.mitrovica@gmail.com ose drejtpërdrejt në zyrën për Barazi Gjinore tek zyrtarja për barazi gjinore Besa Veseli (e-mail: besa.veseli@rks-gov.net).


Bashkangjitur gjeni Draft-Planin komunal për Barazi Gjinore për vitin 2024-2026 të miratuar nga Grupi punues për hartimin e Planit komunal për Barazi Gjinore për vitin 2024-2026, i formuar me vendim të veçantë të Kryetarit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	28.06.2024
REFERENCË:	NR. 01-020/04-0036983/2/24
PËR/ZA/TO:	Vesa Broja - Kryesuese e Kuvendit të Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Besa Veseli – Zytare për Barazi Gjinore 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga konsultimi me publikun për Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2024-2026

Hyrje

Duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 61, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; nenit 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenit 19, nenit 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 Për Administratë të Hapur në Komuna, me qëllim të nxitjes dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës; zyrtarja për Barazi Gjinore znj. Besa Veseli, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtoritë komunale dhe Zyrën për Informim, ka shpall konsultimin publik për Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026, për datën 18.06.2024, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 14:00.

Ecuria e procesit

Sekretaria e Kuvendit në harmoni me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 Për Administratë të Hapur në Komuna, ka publikuar njoftimin për konsultim publik të Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2024-2026 në ueb faqen e Komunës tetë ditë para mbajtjes së takimit në <https://kk.rks-gov.net/mitrovicëejugut/wp-content/uploads/sites/18/2024/06/Scan1.pdf> dhe në rrjetet sociale të Komunës.

Njoftimi për konsultim publik është shpallë në afatin e paraparë ligjor, duke u interesuar që të sigurohet njoftim i plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me ftesën për

konsultim publik palët e interesuar janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur Draft - Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2024 -2026

<https://kk.rksgov.net/mitroviceejugut/wpcontent/uploads/sites/18/2024/06/Plani-Lokal-i-Veprimit-per-Barazi-Gjinore-Komuna-e-Mitrovices-2024-2026.docx> që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë	17
2. Publikimi në ueb faqe	8 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	17

Në konsultim publik për Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026 kanë marrë pjesë: znj. Besa Veseli zyrtare për Barazi Gjinore, drejtor të drejtorive komunale, Zyrtari Kryesor Financiar , Sekretaria e Kuvendit, , Zyra për Informim, DHE OJQ-të lokale si dhe qytetarë të Mitrovicës, të evidentuar në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë e këtij raporti.

Gjithsejt në sallë ishin 17 pjesëmarrës, prej tyre 13 femra dhe 4 meshkuj.

Rekomandimet për Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026:

Gjatë konsultimit Publik të mbajtur nga komuna e Mitrovicës në datën 18.06.2024 u dhanë nga të pranishmet/të pranishmit gjithsej 7 rekomandime, dy nga te cilat ishin të planifikuara në Draft PLVBGJ. Për të gjitha këto rekomandime, gjeni në vijim përgjigjet përkatëse:

1. Dizajn urban gjithëpërfshirës– Integrimi i dizajnit “gender-sensitive” në infrastrukturën publike. Shembuj: trotuare më të gjera dhe të përshtatshme si dhe rampa për lëvizje në vende me disnivel për gra, fëmijë, të moshuar dhe persona më aftësi të kufizuara; krijimi i hapësirave rekreuese sic janë parqet me hapësira për lojë, tualete dhe vende për ulje që janë të sigurt dhe lehtë të qasshme për të gjithë.

Përgjigje për rekomandimin 1: Ndërhyrjet infrastrukturore të ndjeshme gjinore janë shumë të rëndësishme dhe propozimi i bërë gjatë degjimit publik është diskutuar me heret me grupin punues, kur po hartohej draft plani. Por meqenese është investuar deri tani në rrugë, trotuare e parqe, nuk u pa me vend që të përfshihej në draft plan nje aktivitet i tille, duke menduar se investimet në këte drejtim janë realizuar, pra për të mos krijuar boshllëk të madh financiar. Nëse KPF e cmon me vend këte sugjerim, dhe nëse Drejtoria përkatëse në Komune ka planifikuar ndërhyrje infrastrukturore që perkojnë me shtrim të rrugëve apo

zgjerrim të trotuareve, padyshim që jemi të gatshëm ta përfshijmë si aktivitet në versionin final të planit përpara dërgimit të tij për miratim në Kuvendin Komunal.

2. Siguria në hapësira publike për gratë – ndricim më i mirë dhe mbikqyrje (kamera) dhe në zona të identifikuar si të pasigurta.

Përgjigje për rekomandimin 2: Siguria në hapësirat publike dhe krijimi i qyteteve të sigurta është një nder çështjet e trajtuara edhe në Kartën Evropiane për Barazimin e Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, mbi të cilën është bazuar nder të tjera, drafti i Planit Lokal i Veprimit për Barazimin e Gjinorëve. Gjate punësive të organizuara për hartimin e draftit të planit e kemi cekur edhe këto çështje madje edhe rolin që mund të luajnë Këshillat Komunale për Sigurinë në Bashkësi në lidhje me sigurinë në hapësirat publike. Megjithatë u kufizuam për të shtuar një aktivitet të tillë në draft, gjithmone për të mos thelluar boshllëkun financiar. Po kështu, një arsye tjetër që u kufizuam, ishte sepse ky është një aktivitet që mund të gjejë vend e të pasqyrohet edhe në Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, që Komuna Mitrovicë duhet ta përgatise dhe miratojë në përmbushje të detyrimit ligjor përkatës. Serish, nëse KPF e gjen me vend si rekomandim dhe Drejtoria përgjegjëse merr përsipër të planifikojë fondet e duhura për kamera e ndricim, jemi të gatshëm ta shtojmë si aktivitet në draftin e planit, përpara përcjelljes së tij për miratim në Kuvendin Komunal.

3. Mobiliteti (lëvizja) – funksionalizmi i transportit publik formal (në Mitrovicë kemi vetëm transport publik joformal dhe taxi) do të lehtësonte lëvizjen e grave (sidomos të atyre në zona rurale) për në punë; kontrolla shëndetësore; edukim etj.

Përgjigje për rekomandimin 3: Edhe kjo është një çështje e diskutuar gjatë hartimit të draftit të planit për rëndësinë që ka, por që grupi punësivë hezitoi ta përfshinte në plan për shkak të mungesës së burimeve financiare adekuate. Nëse KPF e cmon të arsyeshme, njëjloj si për dy rekomandimet me sipër, ne jemi të gatshëm ta reflektojmë këto rekomandime në versionin e draftit të planit që do të përcillet për miratim në Kuvendin Komunal.

4. Planifikim urban i qëndrueshëm – dizajnimi i stacioneve të pritjes për autobus, me ulëse adekuate, strehë dhe ndricim për të ofruar siguri dhe komoditet në vecanti gratë dhe fëmijët.

Përgjigje për rekomandimin 4: Ky rekomandim shkon në linjë me rekomandimin 1 dhe 3, pra përgjigja për këto rekomandime është e njëjta: nëse KPF dhe drejtorite përgjegjëse pajtohen që mund të behen nderhyrje në infrastrukture dhe mobilitet, kjo nderhyrje do shoqërohet me pjesën e ndricimit, të vendosjes së stacioneve të pritjes për autobusa, zgjerimit të trotuareve e vendosjes së rrafshëve, etj.

5. Mbështetje në shërbimet e kujdesit – themelimi i qendrave të kujdesit tërëditor për fëmijët në zona urbane dhe rurale për të mbështetur nënat që punojnë dhe ato që duan të punojnë; krijimi i programeve me bazë komunitetin për kujdesin ndaj të moshuarve që ofrojnë shërbime të kujdesit ditor për të moshuarit ashtu që të reduktohet barra që zakonisht gratë e mbajnë për kujdesin ndaj tyre.

Përgjigje për rekomandimin 5: Rekomandimet për qendrat ditore për fëmijët dhe të moshuarit janë të përfshira në draftin e veprimit që u diskutua në konsultimin publik, konkretisht në aktivitetet: 2.2.2. "Ngritja e qendrës së kujdesit për të moshuarat/moshuarit"

dhe 2.2.3. "Ngritja e qendrës së kujdesit për të fëmijët" (fq. 28 dhe 29 e Draft Planit). Por kosto financiare e tyre është lene te perllogaritet ne baze te kontributit qe do jepet nga Ministria e Financave, Punes dhe Transferave. Programet me baze komunitetin do zhvillohen ne momentin qe keto qendra ngrihen dhe jane funksionale. Gjithsesi mbetemi te hapur te reflektojme cdo koment apo sugjerim shtese, nese do kete KPF.

6. Trajnim i veqantë për zyrtarët e QPS-së.

Pergjigje per rekomandimin 6: Ne diskutimet gjate hartimit te draft PLVBGJ e kemi cekur edhe ceshtjen e trajnimeve te zyrtareve te QPS sidomos ne lidhje me ndryshimet ligjore me te fundit sa i takon Ligjit per Mbrojtje nga Dhuna ne Familje. Por, meqenese i takojne si aktivitet Planit te Veprimit per Mbrojtje nga Dhuna ne Familje, te cilin Komuna e Mitrovices parashikon ta hartojte se shpejti, u mendua qe keto trajnime te reflektohen atje. Gjithashtu, ne trajnimet e parapara ne draft Planin Lokal te Veprimit per Barazine Gjinore me zyrtaret e komunes, ne aktivitetet: 1.2.1. "Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për integrimin gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike në nivel lokal."; 1.2.2. "Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.", etj., është menduar te ftohen edhe zyrtare te QPS. Mbetemi te gatshem te reflektojme ne draft plan cdo sugjerim tjeter qe KPF e gjen me vend ne lidhje me kete rekomandim.

7. Financim të veqantë për banim për viktimat e dhunës në familje që nuk dëshirojnë të qëndrojnë në strehimore.

Pergjigje per rekomandimin 7: Ky rekomandim është i parashikuar ne aktivitetet e paraqitura ne draft Planin Lokal te veprimit per Barazine Gjinore, konkretisht ne aktivitetin: 2.2.5. "Pagesa e qirave për familjet raste sociale me fokus nënat vetushqyese, viktimat e dhunës në familje, etj." (fq.29 e Draft Planit). Me shume mbeshtetje ne kete drejtim dhe pergjithesisht per viktimat e dhunes ne familje do duhet te parashikohet ne draft Planin Lokal te Veprimit per Mbrojtje nga dhuna ne Familje, qe komuna do te hartojte se shpejti.

Duke falenderuar te gjithë personat qe dhane kontributet e tyre ne lidhje me draft Planin Lokal te veprimit per Barazine Gjinore, edhe nje here e theksojme se mbetemi te gatshem te reflektojme ne versionin final te ketij plani, te gjitha sugjerimet qe do te na jape KPF mbi keto rekomandime, apo edhe cdo koment, sugjerim tjeter qe do te kene mbi draft planin ne teresi.

Vlen të theksohet se zyra për Barazi Gjinore nuk ka marrë asnjë vërejtje apo sugjerim me shkrim apo formë tjetër nga ana e publikut gjatë afatit kohor të përcaktuar me (MAPL) Nr. 04/2023 Për Administratë të Hapur në Komuna.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

KONSULTIM PUBLIK

Projekt – Plani Komunal për Barazi Gjinore për vitet 2024-2026

Vendi: Salla e Mediave

Data: 18.06.2024

Ora: 14:00

LISTA E PJESEMARRËSVE

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	MELIHAT BESHIREI	MITROVICË	
2	Kaltrina Behismaj	Mitrovicë	
3	Mehmet Saliçiu	Mitrovicë	
4	Hërmione Ferizij	Mitrovicë	
5	Klerida Kastrah	K. Mitrovicës	
6	Albana Tejs	Mitrovicë	
7	Hanna Ruchiti	-/-	
8	BUNITA SYLA	Mitrovicë	
9	Arif Gërxhi	-/-	
10	Lgjalbe Ismaili	-/-	
11	Zoran Gitali	-/-	
12	Fahrije Kabashi	-/-	
13	Sadije JASHARI	-/-	
14	BEZA VESELI	-/-	
15	Dakir MASHURI	-/-	
16	ARTAN XHAKA	Mitrovicë	
17	Hërdan Rashani	Mitrovicë	
18			
19			
20			
21			
22			